



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



11.nr./ 613 /2025

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës Hani i Elezit në përkrahje të fermerëve për zhvillimit të bujqësisë për vitin 2025 do të bëjë subvencionimin e fermerëve për ngritjen e **3 ha** pemishte (**1 ha arrë, 1 ha mollë dhe 1 ha kumbull**).

Në këtë subvencionim përfshihet furnizimi me fidan me nga 0.20-0.50 ha.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë fermerët / qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit.

Përfitues do të jenë fermerët /bletarët që i plotësojnë këto kritere :

1. Të jetë banor i Komunës Hani i Elezit.
2. Prona të jetë në territorin e Komunës së Hani të Elezit.
3. Të jetë e përshtatshme për kultivim të pemës që aplikon.
4. Të ketë mundësi të ujitjes të pemishtes.
5. Prona të jetë e tij / familjes.
6. Përparësi kanë fermerët që nuk kanë qenë përfitues të subvencioneve Komunale tri vitet e fundit.

Dokumentacioni nevojshëm për aplikim :

- Fletëaplikacioni i plotësuar për aplikim / që merret në Zyrën Pritëse,
- Kopjen e dokumentit identifikues.
- Certifikata e pronës ku do të ngritët pemishtja.

Të interesuarit për më shumë informata për aplikim mund të drejtohen në zyrën e DBPZHR-së, në objektin e komunës.

Afati për aplikim fillon nga data **28.01.2025** deri më **14.02.2025**.

Data: 28.01.2025

Hani i Elezit

Drejtori i DBPZHR-së
Abduraman Bushi

